

**BUSINESS E-BANKING
MANUAL PËRDORIMI**

I. OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI

E-Banking për Bizneset është një platformë online e internet banking ku bizneset kanë mundësinë të kryejnë pagesa të ndryshme ndaj palëve të treta kudo dhe në çdo kohë. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj platforme bizneset mund të marrin informacion mbi depozitat e kompanisë, kartat e kreditit, POS-et e lidhura me llogaritë e kompanisë dhe mbi kreditë e kompanisë. Nëpërmjet kësaj platforme, kompanitë mund edhe të kontrollojnë pagesat e kryera me kartën e kreditit, të ndryshojnë limitin e përdorimit në internet si edhe të paguajnë detyrimin e kartës.

II. MANUALI

Në këtë manual është përshkruar i gjithë procesi i logimit në Degën Internet për bizneset si edhe hapat që duhet të ndiqen për të kryer të gjitha veprimet që shfaqen në menutë përkatëse.

III. LISTA E VEPRIMEVE QË MUND TË KRYHEN NË DEGËN INTERNET

Lista e veprimeve në “Degën Internet për bizneset”	Çmimet ¹
Hapje llogarie rrjedhëse	Falas
Verifikim i veprimeve të llogarisë	Falas
Pasqyrë e llogarisë	Falas
Hapje depozite	Falas
Monitorim i depozitave të kompanisë	Falas
Mbyllje depozite	Falas
Monitorim i kredive të kompanisë;	Falas
Pagesë të Kartës së Kreditit;	Falas
Ndryshim i limitit për blerjet online me Kartë Krediti;	Falas
Informacion mbi Kartën e Kreditit;	Falas
Transferta brenda llogarive të kompanisë;	Falas
Transferta brenda BKT në Lekë dhe monedhë të huaj;	Falas
Transferta brenda vendit;	Sipas Kushteve të Punës në fuqi
Këmbime Valutore	Falas
Pagesë gjoba trafiku;	Falas
Pagesë dogane;	Falas
Pagesë fature utilitare;	Falas
Autorizim i pagesës automatike të faturave;	Falas
Rimbushje celulari për operatorët në Shqipëri	Falas
Pagesë taksash;	Falas
Pagesë të taksave lokale;	Falas
Veprime POS;	Falas
Kalim paga;	Falas
Kalim Transferta në masë;	Falas
Ndryshim fjalëkalimi	Falas
Konfigurim i njoftimeve BKT Smart	Falas

¹Çmimet janë subjekt ndryshimesh dhe për referencë do të merren gjithmonë ato të publikuara tek kushtet e punës së bankës.

1. REGJISTRIMI DHE PROÇESI I LOGIMIT


1.1. Regjistrimi

Regjistrimi është një proces i cili do të lejojë klientin që të regjistrohet në BKT Business E-Banking.

Ju mund të përdorni shërbimin e Degës Internet në BKT nëse:


1. Keni plotësuar pranë degëve të BKT marrëveshjen e KSHBB-së dhe dokumentacionin për aktivizim të shërbimit në Internet për Bizneset;
2. Dini numrin e klientit dhe të kompanisë (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) ose numrin personal të kartës suaj të identitetit dhe numrin e NIPT-it të kompanisë;
3. Keni një numër celular të vlefshëm të regjistruar në bankë.

Për tu aksesuar në shërbimin e degës Internet për Bizneset klikoni në linkun www.bkt.com.al dhe do ju shfaqet dritarja mëposhtë klikoni mbi butonin "Biznes"




Për të realizuar procesin e regjistrimit, ju duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Përzgjidh "Regjistrohu tani"



- Vendosni nr tuaj personal Numri i Identifikimit të përdoruesit të Degës Internet (CIF i përdoruesit i cili është miratuar si përdorues i BEB në Vendimin e Asamblesë) dhe Numrin e Identifikimit të Kompanisë (CIF), plotësoni Kodin e Konfirmimit pastaj klikoni mbi butonin **Vazhdo**



- Në faqen tjetër, plotësoni fushat e mëposhtme:

< Kthehu në faqen hyrëse

Verifikimi Kartës

Tipi Kartës

Ju lutemi zgjidhni

4 Nr. e Fundit të Kartës

.....

Kodi PIN

.....

Vazhdo >

Norton SECURED
powered by digicert

4.Zgjidhni llojin e Kartës suaj

5.Vendosni 4 numrat e fundit të kartës

6.Vendosni Kodin Pin të kartës dhe kliko VAZHDO

- Zgjidhni tipin e kartës tuaj
- Vendosni 4 numrat e fundit të kartës që keni përzgjedhur
- Vendosni PIN e kartës që keni përzgjedhur.
- Në të njëjtën faqe do të shfaqet numri juaj aktual i telefonit i cili do të jetë pjesërisht i koduar (psh:355 67****123)

- Shtypni butonin **Vazhdo** për të vazhduar
- Në numrin tuaj të telefonit do të dërgohet një SMS me kodin që do të vendoset në faqen e FNP-së

Hyje - Mozilla Firefox

https://ebank.bkt.com.al/ebanking-business/login.html#

Business

S'kujtoj Fjalëkalimin

Vendos kodin FNP

Ju lutem plotësoni kodin FNP që ju është dërguar në numrin tuaj të celularit: 355690000390

Vendos kodin FNP

.....

Vazhdo >

Norton SECURED
powered by digicert

7.Vendosni nr 4-shifror(FNP) që vjen në telefonin tuaj dhe kliko VAZHDO

- Shtypni butonin **Vazhdo** pasi të keni formuar FNP që është dërguar në numrin tuaj të celularit
- Do të vazhdoni në një faqe ku do të vendosni fjalëkalimin tuaj në Business E-Banking
- Konfirmoni fjalëkalimin

Në faqen që vazhdon, duhet të vendosni një fjalëkalim që do ta përdorni kur logoheni tek BKT Business E-Banking. Për të përcaktuar fjalëkalimin duhet të keni parasysh rregullat e mëposhtme:

- Fjalëkalimi mund të përmbajë karaktere alphanumerike.
- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere.
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (psh.111111, 123456)

- Pasi të keni shtypur butonin **Vazhdo** do të vazhdoni në faqen tjetër ku do të zgjidhni pullën dixhitale, të cilën do ta shihni për sigurinë tuaj sa herë të logoheni në BKT Internet Banking
- Zgjidhni një kategori nga lista
- Në varësi të kategorisë së zgjedhur, ju do të shihni një listë me pulla dixhitale
- Zgjidhni një pullë dixhitale dhe shtypni butonin **Vazhdo** në mënyrë që të përfundoni procesin tuaj të regjistrimit

Mos vazhdoni më tej në rast se nuk jeni të sigurt për Pullën tuaj Dixhitale të shfaqur në ekran. Klikoni mbi kuti kuadratin blu në rast se konfirmoni se imazhi i shfaqur është Pulla juaj Dixhitale

Kategoria

Ju lutemi zgjidhni



Vazhdo >

9. Zgjidh njerën nga Pullat Digitale dhe kliko VAZHDO

1.2. Hyrje(Logimi)

Hyrja është një proces që lejon klientin që të logohet në BKT Business E-Banking. Vetëm përdoruesit e regjistruar mund të logohen në BKT Internet Banking. Përdoruesit e regjistruar duhet të plotësojnë hapat në vazhdim në mënyrë që të futen në BKT Internet Banking:

Hyrje

Login


Numri Klientit / Numri Personal

Numri Kompanisë / NIPT

Fjalëkalimi

Përdor Tastierën Virtuale S'kujtoj Fjalëkalimin

Vazhdo >



Regjistrohu tani

BKT nuk do t'ju dërgojë asnjëherë emaille ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik i gjerë (p.sh Internet kafe).
Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, Ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 4 22 66 288 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj.
Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më lart.

3.Vendosni fjalëkalimin e krijuar dhe kliko VAZHDO

1.Vendosni numrin e klientit në BKT ose numrin personal tuaj(SSN)

2.Vendosni numrin e kompanisë në BKT ose NIPT-in

- Vendosni numrin e klientit (CIF) dhe numrin e kompanisë (CIF), fjalëkalimin e Internet Banking dhe shtypni butonin **Vazhdo**
- Në faqen tjetër, do të shfaqet pulla dixhitale që keni zgjedhur në mënyrë që të vazhdoni në faqen e FNP
- Ju lutem të informoni BKT Call Center nëse pulla dixhitale ka ndryshim me pullën që ju keni zgjedhur
- N.q.s pulla dixhitale është e saktë, po ajo që ju keni zgjedhur shtypni butonin **Vazhdo**
- Një SMS do të dërgohet në numrin e celularit tuaj, të cilin ju do ta vendosni në faqen e FNP-së

- Shtypni butonin **Vazhdo** pasi të keni vendosur FNP që është dërguar në celularin tuaj në mënyrë që të përfundoni procesin e logimit

Probleme me logimin:

Nëse bllokoni llogarinë tuaj në Internet Banking për shkak të fjalëkalimit të gabuar ose FNP-së kontaktoni BKT Call Center në numrin e telefonit (0)4 22 66 288

Nëse ju harroni fjalëkalimin ose Numrin e klientit kontaktoni BKT Call Center në numrin e telefonit (0)4 22 66 288

1.3. Faqja Kryesore (Kreu)

Në këtë faqe ju mund të shihni një përmbledhje të shkurtër të llogarisë suaj. Mund të merrni informacion rreth balancës së llogarive, Depozitave, Kredive dhe Transfertave.

The screenshot shows the main dashboard of the BKT Internet Banking system. The interface includes a left-hand navigation menu, a top header with the user's name, and a main content area with several data widgets. Callout boxes are used to identify specific elements:

- Menuja kryesore:** Points to the vertical navigation menu on the left side of the page.
- Depozitat dhe llogaritë:** Points to the 'Asetet' widget showing a balance of 10 ALL.
- Totali i llogarive:** Points to the 'Gjendje e disponueshme' widget showing a balance of 10 ALL.
- Limiti i kartës:** Points to the 'Limiti Disponueshem i Kartës' widget showing a balance of 0 ALL.
- Tabela e Kurseve të këmbimit:** Points to the 'Kursi i Këmbimit' table.
- Veprimet e Fundit:** Points to the 'Veprimet e Fundit' table.
- Kalendari:** Points to the 'SHK 2020' calendar widget.

Monevha	Blerje	Shitje
ALD	74.300	75.500
CAD	83.350	84.650
CHF	113.400	115.200
EUR	121.500	122.250
GBP	143.350	145.600
TRY	17.800	18.200
USD	111.300	112.300